



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: Tetor 2022

Nr:

PROJEKT UDHËZIM
PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E MONITORUESVE NË
ZGJEDHJE DHE PROCEDURËN E EMËRIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n”, e 2, dhe nenit 92/4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë:

- objektin dhe periudhën e monitorimit,
- kriteret e përzgjedhjes dhe procedurën e emërimit të monitoruesve,
- mënyrën e raportimit sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 2

Periudha e monitorimit dhe emërimi i monitoruesve

- Periudha e monitorimit fillon 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve dhe përfundon ditën e zgjedhjeve deri në orën e mbylljes së votimit.
- Jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton një numër të mjaftueshëm personash për kryerjen e monitorit sipas këtij udhëzimi.
- Personat e caktuar i nënshtrohen trajnimeve nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve para fillimit të periudhës së monitorimit.



Data: Tetor 2022

Nr.

Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe procedurën e emërimit të tyre

Neni 3

Objekti i monitorimit

1. Monitorimi bëhet në emër dhe për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe synon vlerësimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë së partive politike, subjekteve zgjedhore, kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie dhe këshillat bashkiakë me kushtet e kërkesat e Pjesës VII, të Kreut I, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe përcaktimet e parashikuara me akte të tjera nënligjore të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve.
2. Monitoruesit vëzhgojnë edhe veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, apo titullarëve të tyre në raport me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Pjesën VII, Kreu I të Kodit Zgjedhor dhe aktet e tjera nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Monitorimi kufizohet në vëzhgimin lehtësisht të verifikueshëm të respektimit të përmbushjes së detyrimeve nga ana e partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve për periudhën e monitorimit, si më poshtë vijon:
 - a) Organizimi i takimeve, veprimtarive e tubimeve elektorale,
 - b) Përdorimi i materialeve propagandistike, ngritja dhe veprimtaria në zyrat zgjedhore, referuar udhëzimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përdorimin e materialeve propagandistike,
 - c) Respektimi i ndalimeve dhe kufizimeve për veprimtari të caktuara para datës së zgjedhjeve si dhe përdorimi/shpërdorimi i burimeve shtetërore gjatë periudhës së monitorimit.

Neni 4

Modalitetet e monitorimit dhe mënyra e raportimit

1. Monitoruesi mbledh informacionin për monitorimin e partive politike, subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve mbështetur në:
 - a) vëzhgimin e drejtpërdrejtë të aktiviteteve të partisë politike, subjektit zgjedhor, kandidatëve, dhe të organeve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, si dhe titullarëve të tyre,
 - b) intervistat me kandidatët ose kryetarët/përfaqësuesit e partive politike, drejtuesit e fushatës së partive politike/subjekteve zgjedhore si dhe stafit mbështetës të tyre,
 - c) identifikimin dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë të zyrave zgjedhore dhe të materialeve propagandistike,



- ç) identifikimin dhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë të takimeve, veprimtarive e tubimeve elektorale të partive politike, subjektet zgjedhore dhe kandidatët.
1. Monitoruesi mbledh informacion për monitorimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore qendrore ose vendore, apo titullarëve të tyre nëpërmjet:
 - a) vëzhgimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve të tyre,
 - b) vëzhgimit të mediave për identifikimin e veprimtarive të institucioneve publike.
 2. Monitorimi nuk duhet t'i ekspozojë monitoruesit ndaj rreziqeve të panevojshme.
 3. Monitorimi nuk kërkon që monitoruesit të llogarisin shpenzimet totale për periudhën e monitorimit nga partia politike, subjekti zgjedhor ose kandidatët ose variablat e ndryshme financiare, që kërkojnë mbledhje të metadatave të zgjeruara.
 4. Monitoruesi ka të drejtë të kërkojë nga subjektet që i nënshtrohen monitorimit, sipas këtij udhëzimi, të vendosin në dispozicion të tij informacionin për veprimtaritë e tyre. Kërkesa nga monitoruesit paraqitet me shkrim duke vënë në dijeni në të njëjtën kohë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në rast se marrësi nuk i përgjigjet asaj brenda 3 (tre) ditëve, monitoruesi njofton menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Në rast konstatimi të një shkeljeje flagrante, monitoruesi njofton menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me çdo mjet komunikimi, dhe plotëson raportin sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund t'i kërkojë monitoruesit informacion shtesë për shkeljet e pretenduara.
 6. Monitoruesi duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportet e ndërmjetme, të plotësuara elektronikisht, çdo 10 (ditë) nga fillimi i periudhës së monitorimit deri në ditën e zgjedhjeve, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
 7. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas ditës së zgjedhjeve monitoruesi depoziton në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportin përfundimtar të monitorimit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Neni 5

Kriteret dhe mënyra e aplikimit

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton me shpallje publike thirrjen për të aplikuar si monitorues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku përfshihet informacion për kriteret e përzgjedhjes dhe funksionet e monitoruesit. Aplikimi kryhet në mënyrë elektronike në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



2. Kriteret për të aplikuar si monitorues janë si vijon:
 - a) të jetë i padënuar,
 - b) të ketë përfunduar studimet universitare ose të jetë duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë.
 - c) të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike të paktën 2 (dy) vitet e fundit.
3. Aplikantët për monitorues duhet të paraqesin dokumentacionin si më poshtë:
 - a) kërkesën për t'u emëruar si monitorues që përmban: qarkun për të cilin aplikon, përvojën e aplikantit dhe adresën e banimit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e tel./cel.,
 - b) dëshmi penaliteti,
 - c) kopje të noterizuar të diplomës ose vërtetim që është duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë të noterizuar,
 - ç) Kopje të dokumentit të identifikimit,
 - d) Vetëdeklarim se nuk është anëtar i ndonjë partie politike për 2 (dy) vitet e fundit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4 që i bashkëlidhët këtij udhëzimi,
 - dh) Raport të aftësisë për punë,
 - e) Vetëdeklarim i banimit,
 - ë) Fotokopje e certifikatës si monitorues në zgjedhje të mëparshme (nëse disponojnë).
4. Në momentin e regjistrimit të kandidatëve për deputetë, kryetarë bashkie ose anëtarë të këshillit bashkiak, monitoruesit depozitojnë formularin e dytë për mungesën e konfliktit të interesit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Në këtë rast monitoruesit deklarojnë se nuk janë në konflikt interesi për shkak se nuk kanë prindërit, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen ose fëmijët madhorë kandidatë të subjekteve zgjedhore. Në rast të kundërt monitoruesit i ndërpritet kontrata e shërbimit dhe zëvendësohet në këtë detyrë nga një monitorues tjetër.
5. Mosdeklarimi i saktë i të dhënave ose deklarimi i rremë nga ana e monitoruesve, passjell për deklaruesin përgjegjësi sipas ligjit.
6. Caktimi i numrit të monitoruesve bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Neni 6

Verifikimi paraprak dhe procedura e certifikimit si monitorues

1. Struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikon paraprakisht plotësimin e kriterëve formale në bazë të dokumentacionit të depozituar dhe i propozon listën paraprake Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga



përfundimi i afatit të aplikimit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, miraton me vendim listën paraprake të aplikantëve.

2. Aplikantët e përzgjedhur i nënshtrohen trajnimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për anën teorike dhe praktike të njohurive për Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e listës paraprake personat e skualifikuar mund të bëjnë ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Neni 7

Procedura e caktimit

1. Përzgjedhja dhe emërimi i monitoruesve bëhet në bazë të parimit të konkurrimit të lirë, të barabartë dhe garancisë për mungesën e konfliktit të interesave.
2. Monitoruesi duhet të ushtrojë përgjegjësitë dhe të kryejë detyrat e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme, jo diskriminuese dhe transparente. Monitoruesi gjatë periudhës së monitorimit nuk mund të kryejë veprimtari që bien ndesh me qëllimin e monitorimit.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve cakton me short monitoruesit. Si rregull, shorti hidhet publikisht jo më vonë se 2 (dy) muaj përpara fillimit të periudhës së monitorimit. Procedura e hedhjes së shortit për caktimin e monitoruesve organizohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Aplikantët e përzgjedhur kanë të drejtë të jenë të pranishëm në hedhjen e shortit. Pas hedhjes së shortit për caktimin e monitoruesve vijohet me shortin për caktimin e zonave të monitorimit.
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përjashton nga procedura e shortit aplikantë, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktuale me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Përjashtimi shtrihet në 2 (dy) zgjedhje të përgjithshme të njëpasnjëshme.
6. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton listën e kandidatëve fitues për monitorues dhe në fund të përmbushjes me sukses së detyrave të caktuara i pajis ata me Certifikatën e Monitoruesit. Certifikata merret vetëm një herë dhe monitoruesi i certifikuar i nënshtrohet trajnimeve vijuese të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
7. Objekti i monitorimit, zona gjeografike e monitorimit për çdo monitorues, kushtet e shërbimit për monitorimin së bashku me shpërblimin për monitoruesin përcaktohen në kontratën e shërbimit. Modeli i kontratës tip miratohet me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Monitoruesit e përzgjedhur me short nënshkruajnë kontratën e shërbimit. Në çdo rast kontrata fillon të zbatohet 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve.

8. Monitoruesit regjistrohen në Regjistrin e Monitoruesve që mbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 8

Informimi i publikut

1. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve informon publikisht fillimin e procesit të monitorimit në kohën e emërimit të monitoruesve, si dhe paraqet rregullisht informacion në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për veprimtarinë dhe rezultatet e monitorimit gjatë periudhës zgjedhore.
2. Monitorimi sipas këtij udhëzimi dhe rezultatet e tij bëhen pjesë e Raportit Vjetor që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve paraqet në Kuvend.

Neni 9

Shfuqizim

Udhëzimi nr.1, datë 2.2.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kritereve për përzgjedhjen e monitoruesve, procedurën, emërimin dhe objektin e monitorimit”, shfuqizohet.

Neni 10

Hyrja ne fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Shtojca nr.1

Raport mbi shkeljen flagrante gjatë monitorimit

I. Informacion i Përgjithshëm

Vëzhgues: (Emri, mbiemri)	
Rajoni/Njësia Aministrative monitoruar:	e
Subjekti/Kandidati Zgjedhor:	
Enti Publik (nëse është rëndësishme):	e
Data:	
Ora:	

II. Lloji i shkeljes së vëzhguar (shëno kutinë për shkeljen e vërejtur)

A. Aktivitetet e Fushatës

Neni 78	
<input type="checkbox"/>	Fushata zgjedhore në një institucion publik [Neni 78, pika 6]
<input type="checkbox"/>	Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllimin marrjen e nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike. [Neni 78, para 7]
<input type="checkbox"/>	Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon ose mbulon shpenzimet për koncerte, evente kulturore dhe argëtuese ose aktivitete bamirësie. [Neni 78, pika 9]
<input type="checkbox"/>	Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5(pesë) qind Lekë për artikuj ose materiale zgjedhore. [Neni 78, pika 10]
Neni 79	
<input type="checkbox"/>	Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyrat zgjedhore. [Neni 79, para 2]
<input type="checkbox"/>	Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike [Neni 79, para 3]
Udhëzimi nr.6 datë 23.03.2021 i KQZ-së	
<input type="checkbox"/>	Zyrat zgjedhore janë hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve
<input type="checkbox"/>	Materiale propagandistike të vendosura në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative,parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
<input type="checkbox"/>	Materiale propagandistike të vendosura në mjete që operojnë në transportin publik.

B. Abuzimi/ keqpërdorimi i burimeve shtetërore

<input type="checkbox"/>	Përdorimi i detyruar në fushatën zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore. [Neni 91, para 2]
<input type="checkbox"/>	Përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit të mësimit i studentëve të sistemit shkollor para-universitare në fushatën zgjedhore. [Neni 91, para 2]
<input type="checkbox"/>	Premtimi ose ofrimi i përfitimeve ndaj nëpunësve publike, ose studentëve për të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ose shkollës ose të ushtruarit e presionit mbi to për këtë qëllim. [Neni 91, para 2]
<input type="checkbox"/>	Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara. [Neni 91, para 3]
<input type="checkbox"/>	Ndalimi në propozimin, aprovimin ose nxjerrjen e akteve ligjore ose akteve nënligjore që përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve (p.sh. rroga, rritja e pensionit, amnistia fiskale.) [Neni 91, para 4]
<input type="checkbox"/>	Mos raportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryer nga institucione publike vendore dhe qendrore, si dhe agjensi shtetërore dhe/ose ndërmarrje. [Neni 92, para 1, para 6]
<input type="checkbox"/>	Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja. [Neni 91, para 5 dhe vendimi nr.9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator]

III. Përshkrim i shkurtër i shkeljeve të vërejtura duke përdorur pyetjet e listuara në kuti për t'ju udhëzuar:

Kur? Kur filloi/ndodhi shkelja?

Ku? Në cilën pjesë të zonës zgjedhore (rajon/Njësi Administrative) monitorohet?

Cfarë? Cilat veprime përbëjnë shkeljen?

Kush? Kush, përvec subjektit/kandidatit zgjedhor të emëruar ishte përfshirë në shkelje dhe/ose ishte dëshmitar i aktivitetit?

Përshkrim:

IV. Detaje të shkeljeve të vërejtura:

Lloji i shkeljes	Detaje	Dokumentacioni që nevojitet
Zyrat Zgjedhore	<ul style="list-style-type: none">• Më afër se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve?• Nëse po, sa është distanca fikse e vëzhguar ?	<ul style="list-style-type: none">• Foto të zyrave elektorale dhe matja e distancës së tyre nga KZAZ,QV dhe VNV?

<p>Materialet propagandistike të fushatës zgjedhore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale? • Nëse po, distanca ndërmjet zyrës elektorale dhe materialeve propagandistike? • Përdorimi i materialeve edukative si materiale statike ose anasjelltas. • Vendosja e materialeve propagandistike • Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike • Vendosja e materialeve propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative,parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit. • Vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik. 	<ul style="list-style-type: none"> • Foto të materialeve propagandistike • Mostra/kopje të printuara të materialeve propagandistike
---	--	---

<p>Aktiviteti/Ngjarja e Fushatës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fushatë zgjedhore në një institucion publik; • Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllim marrjen e nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike. • Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon ose mbulon shpenzimet për koncert, ngjarje kulturore dhe zbavitëse ose aktivitete bamirësie. • Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5 (pesë) qind Lekë për sende ose materiale të fushatës zgjedhore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Foto të aktivitetit/ngjarjes së fushatës • Dëshmi të njerëzve të pranishëm në ngjarjen e fushatës; • Dëshmi të njerëzve që kanë marrë ose që u është premtuar të marrin para, të mira materiale, vende pune ose favore të tjera për të votuar për një kandidat/subjekt zgjedhor
<p>Abuzimi i burimeve shtetërore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Angazhimi i detyruar i nëpunësve publik/njësive administrative në aktivitetet e fushatës gjatë orarit të punës (shpërndarja e materialeve, pjesëmarrja në takime, puna si staf i fushatës); • Shpërndarja tek nëpunësit publikë e të mirave dhe shërbimeve të blera me fonde publike ose presioni i ushtruar tek ata, për të marrë pjesë në ngjarjet e fushatës jashtë orarit të punës; • Punësimi, pushimi nga puna, kontratat e përkohshme ose afat-shkurtër të punësimit gjatë fushatës zgjedhore; • Nisja e propozimeve, aprovimeve ose nxjerrjen e akteve ligjore, si dhe akteve nënligjore nga të cilat përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve (p.sh. rroga, rritja e pensionit, amnistia fiskale); • Mos raportimi tek KQZ-ja nga ana e institucioneve publike, vendore dhe qendrore, agjensitë shtetërore dhe/ose aktivitetet e ndërmarrjeve të një natyre publike 4 muaj para datës së zgjedhjeve; • Aktivitete të ndaluara nga KQZ-ja që mund të jenë të 	<ul style="list-style-type: none"> • Foto të aktivitetit/ngjarjes së fushatës që tregojnë prezencën e nëpunësve publik/komunës (dhe pjesëmarrjen e tyre aktive) dhe përdorimi i automjeteve shtetërore/Njësive Administrative; • Fotografi (screenshot) të faqeve zyrtare të internetit, që tregojnë njoftimin e fillimit të projektit shoqëror/publik ose promovimin e arritjeve të fuksionarëve; • Screenshot-e të faqeve institucionale të internetit të institucioneve publike, vendore dhe qendrore, agjensi shtetërore dhe/ose ndërmarrje që tregojnë aktivitete të një natyre publike që lidhen me rregjistrin e KQZ-së;

	<p>një natyre publike dhe transmetimi ose mbulimi mediatik i aktiviteteve të ndaluara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i mjediseve të njësive administrative /shtetërore pa u privuar, që dhe kandidatëve të tjerë u garantohet përdorimi i këtyre mjediseve në të njëjtat kushte; • Prezantimi i projekteve shoqërore/publike fillimi i të cilëve përkon me periudhën e fushatës zgjedhore dhe që nuk janë lajmëruar paraprakisht; • Përdorimi i shërbimeve publike të e-mailit /faqeve të internetit ose promovimi i arritjeve të funksionarëve përmes faqes institucionale të internetit; • Përdorimi i automjeteve (të bashkive /shtetërore) /mjediseve publike për qëllimet e fushatës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistrimet e reklamave/spoteve që transmetohen në TV dhe radio që promovojnë disa aktivitete të një natyre publike; • Foto të shpërndarjes së të mirave/shërbimeve tek votuesit, si dhe dëshmi të njerëzve që u janë ofruar avantazhe të tilla ose nëpunësit publikë që u është ushtruar presion për të marrë pjesë në ngjarjet e fushatës jashtë orarit të punës. • Raportin e gjetjeve të mosraportimit të aktiviteteve publike nga organet e administratës publike shoqëruar me pamje filmike, fotografike dhe informacion të detajuar për gjetjet.
--	---	--

Shtojca nr.2

Raporti i ndërmjetëm i monitorimit

I. Përmbledhje

Vëzhguesi: (Emri, mbiemri)	
Rajoni/ Komuna e monitoruar:	
Subjektet zgjedhore të monitoruar:	
Periudha e mbuluar nga raporti:	
Data e dorëzimit të raportit:	
Nënshkrimi	

Shënim: për Seksionin II (monitorimi i aktiviteteve të fushatës), një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e dhënë. Për seksionin III (monitorimi i abuzimit/ keqpërdorimit të burimeve shtetërore), një raport duhet të plotësohet për të gjithë zonën gjeografike të monitoruar.

II. SUBJEKTI ZGJEDHOR –AKTIVITETET E MONITORUARA TË FUSHATËS

Një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e mëposhtëm.

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor _____ (shtoni emrin e subjektit zgjedhor)

1. Përmbledhja e aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor

Lloji i aktivitetit të monitoruar	Detaje	Parregullsi për tu përmendur këtu dhe për tu identifikuar më vonë
a) Zyrat zgjedhore	Numri dhe vendndodhja e zyrave zgjedhore të monitoruara	Po/ Jo
b) Ngjarjet e Fushatës	Numri i aktiviteteve të monitoruara të fushatës të organizuara nga subjekti zgjedhor të cilat u monitoruan	Po/ Jo
c) Materialet propagandistike	Numri i materialeve të monitoruara (të bashkangjiten mostra/foto për secilen)	Po/ Jo
	Numri i materialeve vizive propagandistike të shqyrtuara për përfshirjen e shënimit: 'Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...'	Po/ Jo
	Materiale propagandistike të vendosura në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente	

rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative,parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit. Po/ Jo

Materiale propagandistike të vendosura në mjete që operojnë në transportin publik. Po/ Jo

d) Monitorimi i Faqeve te Internetit Identifikimi i platformave të faqeve të internetit Po/ Jo

2. Detaje të aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor

a) Zyrat zgjedhore

#	Vendndodhja/Adresa	Madhësia	Detaje të tjera (pajisje teknike, materiale promocionale, materiale të printuara etj.)
1			
2			

b) Aktivitetet e Fushatës

#	Vendndodhja	Ora dhe Data	Nr. i të pranishëmve	Detaje të tjera (pajisje teknike, materialet e fushatës etj.)
1				
2				

c) Materialet Propagandistike

#	Lloji i materialeve propagandistike	Përfshirja e shënimit: "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të"	Përshkrimi (madhësia, materiali, cilësia...)
1			
2			

d) Rrjetet Sociale

#	Platforma	Dita e postimit/ reklamës	Llogaria	Detaje të tjera (përmbajtja, audiencia e synuar.)
1				
2				

3. Parregullsitë e vëzhguara

Të gjitha raportet e incidenteve duhet ti bashkëngjiten këtij raport.

Neni	Parregullsia	Data e Raportimit të Parregullsisë tek KQZ-ja	Raporti i incidentit i bashkëngjitur
Neni 78, pika 6	Fushata zgjedhore në një institucion publik		Po/Jo

Neni 78, pika 7	Subjektet zgjedhorë/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllimin e marrjes së nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike.		Po/Jo
Neni 78, pika 9	Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon ose mbulon shpenzimet për koncert, ngjarje kulturore dhe argëtuese ose aktivitete bamirësie.		Po/Jo
Neni 78, pika 10	Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5 (pesë) qind Lekë për artikull ose material.		Po/Jo
Neni 79, pika 2	Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale		Po/Jo
Neni 3, paragrafi 2 Udhëzim nr.6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Materiale propagandistike të vendosura në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative,parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.		Po/Jo
Neni 3, paragrafi 3 Udhëzim nr.6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Materiale propagandistike të vendosura në mjete që operojnë në transportin publik.		Po/Jo

Neni 5,paragrafi 1, Udhëzim nr.6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Zyrat zgjedhore janë hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve		Po/Jo
Neni 79, pika 3	Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike		Po/Jo

III. Raport mbi monitorimin e abuzimeve ndaj burimeve shtetërore

Ky raport monitorimi plotësohet për të gjithë zonën e monitoruar, duke përdorur formularin e mëposhtëm:

1. Përmbledhje e Aktiviteteve të Monitoruara

Lloji i aktivitetit të monitoruar	Detaje	Parregullsi për tu përmendur këtu dhe për tu identifikuar me vonë
a) Monitorimi i Faqeve te internetit	Identifikimi i platformave të monitoruara të faqeve të internetit	Po/ Jo
b) Përdorimi i burimeve shtetërore	Numri dhe identifikimi i aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të nëpunësve të administratës gjatë orarit të punës.	Po/ Jo

Numri dhe identifikimi i Po/ Jo aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të studentëve para-universitar brenda orarit të mësimit.

Numri/Identifikimi i institucioneve publike mjediset e të cilëve u monitoruan për të parë nëse po përdreshin për aktivitetet e fushatës.

Përdorimi i automjeteve publike të vëzhguara në ngjarjet e fushatës.

c) Aktivitete të natyrës publike

Numri i aktiviteteve të një natyre publike të monitoruara të cilat kërkojnë njoftimin/raportimin tek KQZ-ja.

2. Abuzimi i burimeve shtetërore- Parregullsitë e vëzhguara

Të gjitha raportet e parregullsive të vëzhguara duhet ti bashkëngjiten këtij raporti.

Neni	Parregullsia	Data në të cilën çdo parregullsi u raportua tek KQZ-ja	Raporti i Parregullsisë i Bashkëngjitur
Neni 91, pika 2	Përdorimi i detyruar në fushatën zgjedhore të administratës publike brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.		Po/Jo

Neni 91, pika 2	Përdorim i detyruar dhe organizuar i studentëve të sistemit shkollor para universitar brenda orarit të mësimit në fushatën zgjedhore		Po/Jo
Neni 91, pika 2	Premtimi ose ofrimi i përfitimeve punonjësve, ose studentëve për të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ose shkollës ose të ushtruarit e presionit mbi to për këtë qëllim.		Po/Jo
Neni 91, pika 3	Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara.		Po/Jo
Neni 92, pikat 1, e 6	Mos raportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryera nga institucione publike, lokale dhe qendrore, si dhe agjensitë shtetërore dhe/ose ndërmarrjet		Po/Jo
Neni 91, pika 5	Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja.		Po/Jo

Raporti përfundimtar i monitorimit

I. Përmbledhje

Vëzhguesi: (Emri, mbiemri)	
Rajoni/ Njësia administrative e monitoruar:	
Subjektet Zgjedhore të monitoruar:	
Periudha e mbuluar nga raporti:	
Data e dorëzimit të raportit:	
Nënshkrimi	

Shënim: për Seksionin II (monitorimi i aktiviteteve të fushatës), një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e dhënë. Për seksionin III (monitorimi i abuzimeve/ keqpërdorimeve të burimeve shtetërore), një raport duhet të plotësohet për të gjithë zonën gjeografike të monitoruar.

II. Subjekti Zgjedhor – AKTIVITETET E MONITORUARA TË FUSHATËS

Një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e mëposhtëm.

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor _____ (shtoni emrin e subjektit zgjedhor)

1. Përmbledhja e aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor

Lloji i aktivitetit të monitoruar	Detaje
--	---------------

- | | |
|-------------------------------|---|
| a) Zyrat Zgjedhore | Vendndodhja e zyrave zgjedhore të monitoruara |
| b) Ngjarjet e Fushatës | Numri i plotë i ngjarjeve të monitoruara të fushatës të mbajtura nga E/s që CM monitoroi |
| c) Materialet propagandistike | Numri i plotë materialeve propagandistike të monitoruara (të bashkangjiten mostra/foto për secilen) |
-

Numri i plotë i materialeve vizive propagandistike të shqyrtuara për përfshirjen e shënimit: 'Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...'

d) Monitorimi i Faqeve të Internetit Listë gjithëpërfshirëse e platformave të faqeve të internetit të monitoruara

2. Parregullsitë e vëzhguara

Neni	Parregullsia	Numri i parregullsive të raportuara në KQZ dhe datat e tyre
Neni 78, pika 6	Fushata zgjedhore në një institucion publik	
Neni 78, pika 7	Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllimin marrjen e nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike.	
Neni 78, pika 9	Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon, bën ose mbulon shpenzimet për koncert, ngjarje kulturore dhe zbavitëse ose aktivitete bamirësie.	
Neni 78, pika 10	Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron sende ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5 (pesë) qind Lekë për send ose material.	
Neni 79, pika 2	Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale	

Neni 3,paragrafi 2, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Materiale propagandistike të vendosura në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative,parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.	
Neni 3, paragrafi 3, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Materiale propagandistike të vendosura në mjete që operojnë në transportin publik.	
Neni 5, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Zyrat Zgjedhore të subjekteve zgjedhore janë hapur në distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.	
Neni 79, pika 3	Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike	

I. Raport mbi monitorimin e abuzimeve ndaj burimeve shtetërore

Ky raport monitorimi plotësohet për të gjithë zonën e monitoruar, duke përdorur formularin e mëposhtëm:

1. Përmbledhje e Aktiviteteve të Monitoruara

Lloji i aktivitetit të monitoruar	Detaje
--	---------------

a) Monitorimi i Faqeve te Internetit Listë gjithëpërfshirëse e platformave të faqeve të internetit të monitoruara

b) Përdorimi i burimeve shtetërore Numri i plotë dhe identifikimi i aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të nëpunësve të administratës gjatë orarit të punës.

Numri i plotë dhe identifikimi i aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të studentëve para-universitar brenda orarit të mësimi.

Numri i plotë/Identifikimi i institucioneve publike mjediset e të cilëve u monitoruan për të parë nëse po përdoreshin për aktivitete të fushatës.

Numri i plotë i vëzhgimeve të bëra për përdorimin e automjeteve publike të vëzhguara në ngjarjet e fushatës.

c) Aktivitete të natyrës publike Numri i plotë i aktiviteteve të monitoruara të një natyre publike të cilat kërkojnë njoftimin/raportimin tek KQZ-ja.

2. Abuzimi i burimeve shtetërore- Parregullsitë e vëzhguara

Neni	Parregullsia	Numri i plotë i parregullsive të vëzhguara dhe data në të cilën cdo parregullsi u raportua në KQZ
Neni 91, pika 2	Përdorimi i detyruar në fushatën zgjedhore të administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.	
Neni 91, pika 2	Përdorim i detyruar dhe organizuar brenda orarit të mësimi të studentëve të sistemit shkollor para-universitar në fushatën zgjedhore.	

Neni 91, pika 2	Premtimi ose ofrimi i përfitimeve punonjësve, ose studentëve për të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ose shkollës ose të ushtruarit e presionit mbi to për këtë qëllim.	
Neni 91, pika 3	Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara.	
Neni 92, pika 1, e 6	Mos raportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryer nga institucione publike vendore dhe qendrore, si dhe agjensi shtetërore dhe/ose ndërmarrje.	
Neni 91, pika 5	Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja.	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Shtojca nr. 4

Formular vetëdeklarimi i mungesës së konfliktit të interesit

Deklaruesi

Unë i/e nënshkruari/a _____, me nr. ID _____, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe udhëzimi nr. __, datë __.10.2022, i Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe procedurën e emërimit të tyre”, pasi nuk kam qenë për 2 (dy) vitet e fundit anëtar/e i/e ndonjë partie politike.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklarimit.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale sipas ligjit për vërtetësinë e deklarimit.

Data e dorëzimit të deklaratës ____ . ____ . 202__

Deklaruesi

(emri, mbiemri, nënshkrimi)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Shtojca nr. 5

Formular vetëdeklarimi i mungesës së konfliktit të interesit

Në momentin e regjistrimit të kandidatëve për deputetë, kryetarë të bashkisë ose anëtarë të këshillit bashkiak monitoruesit depozitojnë formularin e dytë për mungesën e konfliktit të interesit.

Deklaruesi

Unë i/e nënshkruari/a _____, me nr. ID _____, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe udhëzimi nr. __, datë __.10.2022, i Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe procedurën e emërimit të tyre”, pasi nuk kanë prindërit, bashkëshortin/bashkëshorten, bashkëjetuesin/bashkëjetuesen ose fëmijët madhorë kandidatë të subjekteve zgjedhore.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale sipas ligjit për vërtetësinë e deklaramit.

Për deklarime të rreme monitoruesit i ndërpritet kontrata e shërbimit dhe zëvendësohet në këtë detyrë nga një monitorues tjetër.

Data e dorëzimit të deklaramitës ____ . ____ . 202__

Deklaruesi

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

